



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
KOMISIONI I KONKURENCËS**

V E N D I M

nr. 318 , datë 02.06. 2014

Për

“Vendosje gjobe ndaj shoqërisë ndaj ndërmarrjes Heaney Assets Corporation për mosdhënie të dhënash brenda afatit kohor të përcaktuar në Vendimin e Komisionit ”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Znj. Rezana Konomi Zv. Kyetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Z. Koço Broka Anëtar
- Znj. Iva Zajmi Anëtar;

Në mbledhjen e tij të datës 02.06.2014, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: “Mbi zbatimin e Vendimit te Komisionit te Konkurrences nr 311, date 17.04.2014,”Kerkese per sigurimin e te dhenave financiare te shoqerise Anika Enterprises S.A”

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 2, 10-12, neni 73, pika 1), shkronja a).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshem mbi mosveprimin e shoqërisë Heaney Assets Corp. në lidhje me detyrimin që i lind nga Vendimi i Komisionit nr. 311, datë 17.04.2014 në lidhje me depozitimin e të dhënave financiare të shoqërisë Anika Enterprises S.A për vitin 2012”.

V Ë R E N S E:

Pranë Autoritetit të Konkurrencës me anë të shkresës nr. 316 prot, datë 03.09.2013, është njoftuar përqendrimi me objekt shitblerjen e pjeseshme të konsorciumit AMRA Oil SHA (e cila përbëhet nga aksionet e shoqërisë Anika

Enterprises S.A) shoqërisë Armo SHA (indirekt) dhe shoqërisë Europetrol SHA (Europetrol) nga shoqëria Heaney Assets Corp.

Ky transaksion, i cili ndryshon cilësinë e kontrollit në shoqëritë e sipërpërmendura në formën e përfimit të kontrollit direkt dhe indirekt , përbën një përqendrim në bazë të nenit 10 pika 1) , shkronja b) e Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Për të vlerësuar nëse ky përqendrim duhet të autorizohet nga Komisioni i Konkurrencës duhet të plotësohen kriteret e xhiros parashikuar në nenin 12 të Ligjit për ndërmarrjet pjesëmarrëse në përqendrim.

Pala njoftuese ka depozituar të dhënat mbi xhirot për ndërmarrjet pjesëmarrëse (Heaney Assets Corp, AMRA Oil SHA, Europetrol SHA), ndërkohë që me gjithë kërkesat e përsëritura shkresat nr. 316/3 prot, datë 30.09.2013, nr. 316/6 prot, datë 25.10.2013 dhe nr. 316/8 prot, datë 28.11.2013 si dhe shtyrjen e afatit që me shkresë nr. 316/10, 29.01.2014, të Autoritetit të Konkurrencës, ajo nuk ka arritur të vendosë në dispozicion të Autoritetit pasqyrat financiare të shoqërisë Anika Enterprises për vitin 2012.

Komisioni ka marrë Vendim nr. 311, datë 17.04.2014 “Kërkesë për sigurimin e të dhënave financiare të shoqërisë Anika Enterprises S.A”, duke vënë afatin 15 ditore për depozitimin e tyre nga pales njoftuese.

Shoqëria edhe pas përfundimit të afatit të përcaktuar në Vendimin e Komisionit nuk ka dërguar pranë Autoritetit të Konkurrencës të dhënat financiare të shoqërisë Anika Enterprises S.A.

Sjellja e shoqërisë Heaney Assets Corporation në lidhje me sigurimin e informacionit të plotë brenda afatit kohor të përcaktuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 311, datë 17.04.2014, cilësohet si shkelje e lehtë në bazë të nenit 73, pika 1, germa a), për rrjedhojë është e dënueshme me gjobë në masën jo më shumë se 1 % të xhiros totale të vitit financiar paraardhës.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të neneve: 24, (shkronja d); nenit 12, pika 1, nenit 73, pika 1, germa dh e Ligjit nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,(i ndryshuar), dhe nenit 12 të Rregullores “Për gjobat dhe lehtësimin prej tyre”.

VENDOSI:

1. Të gjobisë në vlerën 100.000 (njëqind mijë) Lekë ndërmarrjen Heaney Assets Corporation përfituese e kontrollit të shoqërive AMRA Oil SHA, Armo SHA dhe shoqërisë Europetrol SHA, për mosdhënie të dhënash brenda afatit kohor të përcaktuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 311, datë 17.04.2014.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi dhe procedurave të kontrollit të përqendrimit të njoftuar jo më vonë se data 25 korrik 2014, si dhe njoftimin e paleve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

(_____)
Anëtar

Koço BROKA

(_____)
Anëtar

Iva ZAJMI

(_____)
Anëtar

Rezana KONOMI

(_____)
Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

KRYETAR